



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:080192

Datë: 21.11.2024

Numri i dokumentit: 06489298

K.DH.Sh. II.nr.291/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha çështjen juridike përmbarimore të Inspektorati Farmaceutik me seli në Prishtinë, Instituti B, kati përdhësë, rrethi i QKUK-së, kundër debitorit Z.Z. – pronar i barnatores “Z.Z. B.I” me numër të biznesit ..., me seli në Lipjan, Rr.”...”, nr.6, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së parë- Departamenti për çështje Ekonomike, KPPP.nr.661/23 i dt.29.09.2023, me datën 21.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Z.Z. – pronar i barnatores “Z.Z. B.I” me numër të biznesit ..., me seli në Lipjan, Rr.”...”, nr.6, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së parë- Departamenti për çështje Ekonomike, KPPP.nr. 661/23 i datës 29.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles së parë- Departamenti për çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit P.nr.421/23 të datës 28.03.2023, të Përmbaruesit Privat, Flamur S.Curri,

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave të procedurës përmbare, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta ndryshoj aktvendimin ankimor apo lëndën të kthejë në rivendosje.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbare (LPP), gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbare ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm- vendimit Nr.10/B-002-21 të datës 18.02.2021.

Përmbaresi privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbare P.nr.421/23 të datës 28.03.2023 ka lejuar përmbaremin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të gjobës t'i paguaj shumën prej 1000.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbare.

Kundër urdhrin përmbare debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin e përmbaremit, duke konsideruar se dokumenti për përmbare nuk i plotëson kriteret e përmbareshmërisë sepse nuk ka paraqitur drejt gjendjen faktike me rastin e inspektimit në biznesin e debitorit. I propozon gjykatës që prapësimin e debitorit ta aprovoj.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim

Gjykata Komerciale e Kosovës Dhoma e Shkallës së parë- Departamenti për çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPP.nr. 661/23 i dt.29.09.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbaremit P.nr.421/23 të datës 28.03.2023, të Përmbaresit Privat Flamur S.Curri, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka theksuar se aktvendimi i

kreditorit është i përshtatshëm për ekzekutim dhe përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekuteshmërisë, në të tregohet qartë baza juridike dhe lartësia e detyrimit. Dokumenti përmbartimor i plotëson parakushtet dhe e ka formën e rregullt të aktit, që përmban të gjitha elementet e domosdoshme konform nenit 21,22,23,24 dhe 27 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrimit të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson, se gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se aktvendimi i lëshuar nga kreditori Nr.10/B-002-21 datës 18.02.2021, i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 10.11.2022, për shumën e detyrimit prej 1,000.00 Euro, në këtë rast është dokument përmbartues, e kjo përcaktohet me nenin 22 paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së, me të cilën parashihet se: *“Dokument përmbartues është edhe vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia)”*, dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragrafi 3 dhe neni 27 paragraf 1, të po këtij ligji ku përcaktohet se: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit ”*, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës procedurale dhe zbatim të gabuar të ligjit material, me rastin e refuzimit të prapësimin nuk qëndrojnë.

Kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret vendimi i lëshuar nga kreditori, është dokument përmbartimor dhe i përmbartueshëm dhe cilësia e tillë është konfirmuar me klauzolën e formës së prerë dhe klauzolën e ekzekutueshmërisë dhe si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbartim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit as për shkelje tjera të pretenduara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, pasi që në këtë rast gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes

për prapësimin e debitorit nuk ka gjetur se ekziston ndonjëri nga shkaqet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP-së për aprovim të prapësimit.

Në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga këto dokumente rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoi përmbartimin.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.291/24 me datë 21.11.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha